




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TRIBUNA CHANNEL  
Besiana HOTI  
Drejtoreshë  
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/53 KPM vs TRIBUNA CHANNEL  
Ref:1708/778/KPM/am

### VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2017/53 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër  
TRIBUNA CHANNEL (“Pala Përgjegjëse”)**

---

#### Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 15 qershor 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM gjatë kohës së fushatës zgjedhore ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, me theks të veçantë prezencën e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.
4. KPM bazuar në monitorimet që janë bërë gjatë fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin për Zgjedhjet Nr. 03/L-073 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijë. Spoti është identifikuar si spot me pagesë nga subjekti politik AAK.

#### Analiza Ligjore

1. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka

transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijët dhe me këtë ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:


*“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”*

### **Vendimi**

2. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
3. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

### **E drejta për Ankesë**

4. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
5. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI  
Kryetar



10.08.2017  
Datë